



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Prishtinë, 8 maj 2020

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare
dhe
Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Perandori Justinian Nr. 44
Lagja Pejton
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

LËNDA: ***KO 072/20 – Kërkesa e 30 Deputetëve të Republikës së Kosovës për vlerësim të përputhjes së Dekretit të Presidentit Nr. 24/2020 të datës 30 prill 2020, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës***

E nderuara Kryetare Rama-Hajrizi,
Të nderuar Gjyqtarë,

Në cilësinë e Kryetares së Kuvendit, po ju shkruaj lidhur me Shkresën tuaj, datë 30 prill 2020, për të paraqitur para Gjykatës Kushtetuese komentet lidhur me

kërkesën për vendosje meritore në rastin KO72/20. Ju lutem, gjeni të listuara më poshtë komentet lidhur me meritat e rastit.

1. Presidenti i Republikës së Kosovës ka tejkeluar kompetencat e veta kushtetuese, duke u thirrur në garantimin e funksionimit të institucioneve. Në fakt, përmes veprimeve të tij, Presidenti i vendit nuk ka respektuar parimin bazë të secilit sistem demokratik, parim i cili është i mishëruar edhe në sistemin juridik të Republikës së Kosovës: *ndarjen e pushteteve*.
2. Këto komente në cilësinë e Kryetares së Kuvendit, lidhur me rastin KO72/20 ndërlidhen ekskluzivisht me veprimet e Presidentit dhe tejkalimet e funksionit të tij kushtetues në raport me formimin e Qeverisë. Prandaj, është më rendësi të sqarohet së këto komente paraqesin pikëpamjen e bazuar së pari nga këndvështrimi i mbrojtjes së supremacisë së Kushtetutës si akti më i lartë i cili përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit dhe së dyti, mbrojtjen kushtetuese të institucionit të Kuvendit nga marrja e kompetencave ekskluzive të parapara në Kushtetutë.
3. Në këtë kuptim, këto komente paraqiten si në vijim: *së pari*, Presidenti i vendit përmes Dekretit të kontestuar nuk ka respektuar parimin kushtetues së ndarjes së pushteteve. *Së dyti*, Presidenti përmes Dekretit të kontestuar ka synuar të amendamentoj Kushtetutën e vendit, kompetencë e cila i takon ekskluzivisht Kuvendit. *Së fundmi*, Presidenti ka ngërthyer mbi vete kompetenca për interpretimin e Kushtetutës e që sipas së drejtës pozitive i takon Gjykatës Kushtetuese.

A. CENIMI I PARIMIT TË NDARJES SË PUSHTETEVE DHE TEJKALIMI I KOMPETENCAVE NGA PRESIDENTI KARSHI KUVENDIT

4. Paragrafi i parë i nenit 4 të Kushtetutës parasheh se *“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.”* Kjo dispozitë është fundamentale në kuptimin e ndarjes së përgjegjësisë të pushteteve në vend, meqenëse siguron se do të ketë kontroll të vazhdueshëm mes pushteteve dhe parandalon tejkalimin e kompetencave nga cilido institucion kushtetues në Republikën e Kosovës.

5. Në këtë vijë, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës sqaron edhe më tej këtë dispozitë kushtetuese, duke shpjeguar se *“Parimi i ndarjes së pushtetit është aso mënyre e rregullimit të marrëdhënieve mes pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, në të cilën secili nga këto tri pushtete ushtron pushtetin e vet pavarësisht nga dy të tjerat”*. Tutje, Komentari sqaron se *“Pushteti ligjvënës i parlamentit nënkupton se parlamenti është ai organ shtetëror i cili nxjerr rregulla origjinere, të cilat në mënyrë origjinere rregullojnë marrëdhëniet shoqërore.”* Në kuptimin e një pushteti të tillë përfshihet edhe pushteti kushtetutformues, i cili në shumicën e shteteve, në përgjithësi ose pjesërisht, është në juridiksion të Parlamentit. Kjo është për arsye se Kushtetuta në kuptimin material, nuk është asgjë tjetër përveç se ligji themelor i vendit.
6. Parimi i ndarjes së pushteteve është konfirmuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Në paragrafin 54 të rastit KO103/14, Gjykata kishte konstatuar se *“Demokracia kërkon zgjedhjen e atyre që do të përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky është subjekti më i lartë drejtues i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre”*. Edhe në rastin tjetër, KO98/11, Gjykata kishte konstatuar se *“Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit [...]”*
7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës buron nga populli dhe është jetësuar me anë të votimit nga shumica e nevojshme e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke u renditur si bazamenti i funksionimit juridiko-politik të vendit. Secili nen dhe paragraf i Kushtetutës është i pacenueshëm dhe i pandryshueshëm, për sa kohë që përfaqësuesit e sovranit nuk vendosin ndryshe, me anë të procedurave të parapara kushtetuese për ndryshimin e aktit më të lartë juridik të Republikës së Kosovës. Si të tilla, të gjitha dispozitat kushtetuese janë drejtpërdrejtë të zbatueshme nga secili institucion dhe organ në Republikën e Kosovës, siç parashihet edhe në paragrafin 4 të nenit 16 të Kushtetutës, i cili thekson që: *“Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”*
8. Pra, Kushtetuta i ka dhënë shprehimisht të drejtën e kushtetutë-bërjes vetëm Kuvendit të Kosovës, respektivisht deputetëve që kanë fituar mandat në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Kjo e drejtë e Kuvendit është garantuar në nenin 65, paragrafi 2 të Kushtetutës, ku në mënyrë decisive sqarohet se

Kuvendi i Republikës së Kosovës *“vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”*. Procedurat e amandamentimit të Kushtetutës sqarohen tutje në Nenin 144 të Kushtetutës, dhe konkretizohet sërish ekskluziviteti vendimmarrës i Kuvendit lidhur me kushtetut-bërje.

9. Në këtë kuptim, Presidentit të Republikës së Kosovës, me Kushtetutë nuk i njihet në asnjë formë kompetenca e kushtetutë-bërjes. E në rastin konkret, këtë të drejtë nuk e gëzon Presidenti as në kuptim të përcaktimit të afateve kohore lidhur me mandatimin e kandidatit për Kryeministër të vendit, përderisa nuk ekziston një normë e tillë kushtetuese.
10. Sipas Kushtetutës, në procesin e formimit të institucioneve, përkatësisht zgjedhjes së qeverisë, Presidenti ka kompetencë të vetme që t'i propozojë Kuvendit emrin e kandidatit të përcaktuar nga subjekti politik i cili ka fituar shumicën relative në zgjedhje. Deri në momentin kur ky emër i dërgohet Presidentit nga ai subjekt politik, Kushtetuta nuk i ka dhënë Presidentit asnjë kompetencë apo rol aktiv.
11. Si rrjedhojë, bazuar në argumentet e mësipërme, si dhe në shkresat e dërguara nga ana e Presidentit drejt subjektit fitues të zgjedhjeve ku ai konstaton se *“[...] Me keqardhje konstatoj se me veprimet tuaja nuk e keni shfrytëzuar të drejtën e propozimit të kandidatit të ri për ta formuar qeverinë, në pajtim me Vendimin e KQZ-së për certifikim të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës”*, përkatësisht Dekretin e tij, mund të konkludohet që Presidenti ka tejkalar autorizimet e tij kushtetuese në raport me pretendimet e tij për të caktuar afate kushtetuese për nominimin nga subjekti i parë, apo edhe të konstatimit të refuzimit të mandatit, pa një deklaram shprehimor të tillë nga subjekti fitues i zgjedhjeve.
12. Pra, Presidenti i vendit, duke caktuar afat, ka krijuar normë të re kushtetuese, për një çështje për të cilën kushtetuta qëndron e heshtur. Kushtetuta nuk përcakton afate sa i përket kohës që ka në dispozicion subjekti fitues i zgjedhjeve për të dërguar emrin e kandidatit për Kryeministër. Pra, duhet sqaruar se të vetmet afate kushtetuese të përcaktuara në këtë drejtim fillojnë të konsumohen vetëm pas mandatimit formal të mandatarit nga ana e Presidentit të vendit.

13. Në një situatë të tillë, veprimi i Presidentit është i njëanshëm. Në mungesë të një afati kohor, Presidentit i duhet të argumentojë plotësimin e dy kritereve. Fillimisht duhet të argumentojë mbi një refuzim formal nga subjekti që ka dalë i pari në zgjedhje apo një dështim procedural, që nënkupton që kandidati i propozuar nga partia e parë nuk merr shumicën e nevojshme në Kuvend. Që të dyja këto rrethana janë sqaruar në Aktgjykimin Nr.Ko.103/14 të kësaj gjykate të nderuar. Çfarëdo caktimi i afatit mbi kohën në dispozicion të subjektit politik për të caktuar mandatarin, pa dëshmuar njërën nga situatat e lartpërmendura, paraqet plotësim apo modifikim të kushtetutës e që në këtë rast synohet të arrihet përmes dekretit të Presidentit, gjë që nuk parashihet me Kushtetutën e vendit.
14. Çfarëdo plotësimi, ndryshimi apo modifikimi i një teksti sipas fjalorit të Kembrixhit (Cambridge Dictionary) nënkupton amendamentim, apo sipas gjuhës së Kushtetutës së Kosovës edhe ndryshim. Për më tepër, në teorinë e së drejtës kushtetuese, sipas profesorit *Richard Albert*, ky ndryshim i kushtetutës kategorizohet si një ndryshim jo formal dhe dekreti në fakt ka tiparet e një kuazi-amendamenti kushtetues. Në analizat teorike që i janë bërë kuazi-amendamentit kushtetues, nga ana e *prof. Albert*, rezulton se përparësitë e tij janë vetëm politike, pasi që iu siguron akterëve kushtetues që të arrijnë të njëjtin rezultat sikur amendamenti, por në një rrugë shumë më të lehtë, jashtë procedurave parlamentare, të cilat në sistemin juridik të Kosovës janë e vetmja mundësi për ta ndryshuar kushtetutën.
15. Në anën tjetër, Gjykata Kushtetuese duhet të vlerësojë faktin që rreziqet e kuazi-amendamentit janë të natyrës krejtësisht kushtetuese. Katër janë rreziqet substanciale që qartazi ndërlidhen me kushtetutën e Kosovës dhe frymën e saj. *E para*, ato e zbehin vijën e cila ndan kushtetuesen nga jo-kushtetuesja dhe rrezikojnë errësimin e hierarkisë së zakonshme të institucioneve në një demokraci kushtetuese. *E dyta*, mbështetja e këtyre strategjive jo-kushtetuese për ndryshime të nivelit kushtetues mund të zbulojë, apo edhe të përforcojë një mospërputhje ndërmjet dizajnit kushtetues dhe praktikës politike, që akterët kushtetues mund ta shfrytëzojnë si rrjedhojë për qëllime politike. *E treta*, shmangia e rregullave të amendamentimit formal dëmton vetë Kushtetutën dhe qëllimin e kodifikimit. Dhe së fundi, kjo qasje eliminon tërësisht sigurinë juridike që është jetike për funksionimin e një demokracie me sundim funksional të së drejtës.
16. Gjykata Kushtetuese duhet pasur parasysh faktin kryesor dhe esencial që një formë e tillë e ndryshimit të Kushtetutës, sfidon drejtpërdrejt parimin e

supremacisë kushtetuese, saktësisht epërsinë e saj, në mënyrën së si është e specifikuar në nenin 16 të Kushtetutës [Epërsia e Kushtetutës].

17. Nga ky këndvështrim Dekreti i Presidentit nr. 24/2020 është në kundërshtim edhe me nenin 65 të Kushtetutës [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 2 të këtij neni, që thotë: *“Kuvendi vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”*. Rrjedhimisht, veprimi i Presidentit është në kundërshtim edhe me nenin 144 [Amendamentimi], paragrafin 2, që specifikon se *“Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”*.
18. Duke parë afatin kohor që ka përcaktuar dekreti në frymën e këtyre dy neneve, atëherë rezulton se dekreti sfidon njëri nga kompetencat më të rëndësishme dhe përmbajtjesore të Kuvendit që buron nga fakti se Kuvendi është organi më i lartë ligjvënës dhe përfaqësues në vend dhe i vetmi organ që ka kompetencë të amendamenteve Kushtetutën. Rrjedhimisht, ky dekret, duke ndërhyrë në kompetencat e Kuvendit, bie ndesh me nenin 4 të Kushtetutës [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] paragrafin 1 të këtij neni, që përcakton: *“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë”*.
19. Pacënueshmëria e parimit të ndarjes së pushtetit është konfirmuar edhe nga jurisprudenca e vetë Gjykatës Kushtetuese. Siç argumentohet nga Gjykata në rastin KO 98/11, pika 44, parimi i ndarjes së pushtetit është njëra prej bazave që garanton funksionimin demokratik të institucioneve. Mbështetur në këtë përcaktim interpretues të Gjykatës Kushtetuese, dekreti i Presidentit e cenon pikërisht edhe nenin 84 të Kushtetutës [Kompetencat e Presidentit] paragrafin 2, ku specifikohet se Presidenti garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë.
20. Komentari i Kushtetutës së Kosovës sqaron më detajisht këtë dispozitë. Ndërtë tjera, Komentari përcakton se *“ky paragraf nuk mëton të jep ndonjë kompetencë shtesë për Presidentin e Republikës, por vetëm të vendos detyrimin që Presidenti i Republikës ka për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të kompetencave të tij specifike”*. Për më tepër, Komentari qartëson se *“kjo mund të*

keqkuptohet ashtu që Presidenti i Republikës të mund të mbjell praktika të kontrollit të institucioneve tjera shtetërore në bazë të 'detyrimit' të tij formal për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve kushtetuese." Komentari i Kushtetutës e kristalizon detyrimin e Presidentit për garantimin e funksionimit kushtetues të institucioneve, duke qartësuar se kjo dispozitë "e vesh Presidentin e Republikës me rolin e një kundërbalancuesi të vetëm kushtetues të institucioneve tjera shtetërore, gjë që nënkupton se materializimi i këtij funksioni nga ana e Presidentit të Republikës nuk mund të prek në kufijtë e pavarësisë së institucioneve/pushteteve të ndara. "

21. Një qëndrim që do të legjitimonte ose legalizonte një dekret të tillë, do të ndryshonte rrënjësisht sistemin tonë kushtetues, duke i dhuruar dekretive të Presidentit supremaci kushtetuese mbi vet Kushtetutën. Kjo nuk do të duhej të ndodhte në asnjë rrethanë.
22. Madje, Komentari shkon edhe më tej, duke larguar çdo dilemë se *"ky paragraf [84.2] nuk mund të paragjykohet që të 'imitojë' rolin e gjykatës kushtetuese, me që institucioni i Presidentit të Republikës nuk është mekanizëm me garancione standardesh që të mund të ushtrojë rolin e një gardiani gjyqësor të kushtetutës. Në këtë kuptim, presidenti paraqitet si garantues i funksionimit të institucioneve kushtetuese, jo i vetë Kushtetutës në kuadrin e sistemit të tërësishëm të ndarjes së pushteteve"*.
23. Prandaj, përmes këtij Dekreti që cenon parimin e ndarjes së pushtetit, Presidenti ka dështuar të garantojë funksionimin kushtetues të institucioneve që sipas interpretimit të vet gjykatës e cila duke analizuar imunitetin funksional të deputetëve, në pikën 61 të rastit KO 98/11 sqaron se *"ndarja e pushtetit arrihet atëherë kur kuvendi ushtron funksionin e tij të pavarur dhe pa ndërhyrje nga pushteti ekzekutiv apo gjyqësor"*. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një ndërhyrje të Presidentit i cili duke plotësuar kushtetutën me Dekretin 24/2020, u ka pamundësuar deputetëve të ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues të amendamentimit të Kushtetutës.
24. Thirrja e Presidentit në *"garantimin e funksionimit kushtetues të institucioneve"* në asnjë formë nuk nënkupton që Presidenti mund të ndërhyjë në kompetencat kushtetuese të organeve tjera. Nëse Presidenti i vendit do të ushtronte kompetenca edhe të organeve tjera, atëherë ndarja e pushteteve si koncept e parim do të zhvleftësohej në tërësi. Zbatimi i këtij Dekreti do të krijonte precedent të rrezikshëm në raport me parimin e ndarjes së pushteteve, sepse do t'i lejonte Presidentit të vendit të ndërhyjë në kompetencat e Kuvendit si organ ligjvënës. Natyrisht, që me një precedent të tillë, edhe në të ardhmen, do të krijohej hapësirë për bartje të kompetencave

kushtetuese me një dekret presidencial. Kjo do ta bënte Kushtetutën e vendit dokument të pazbatueshëm dhe jorelevant gjatë punës së institucioneve.

25. Për më tepër, një situatë e tillë do të krijonte paqartësi dhe konflikte të njëpasnjëshme ndërmjet institucioneve të vendit gjatë ushtrimit së kompetencave të veta kushtetuese, gjë që do të kishte pasoja të pashmangshme dhe të pariparueshme për një rend juridik të udhëhequr nga premiset e sundimit të ligjit, duke krijuar pasiguri juridike totale, si dhe do të pamundësonte kontrollin dhe balancin mes pushteteve si parim bazë i paraparë në Kushtetutë.
26. Prandaj, Presidenti i vendit ka tejkalluar kompetencat e veta kushtetuese dhe njëkohësisht ka shpërfillur parimin e ndarjes së pushteteve, në momentin kur ai vetë ka caktuar afate të cilat nuk janë të përcaktuara me Kushtetutë, duke shkruar një normë kushtetuese e cila praktikisht nuk ekziston. Ligjvënësi me qëllim nuk ka caktuar afat kushtetues para se të kryhet nominimi formal nga subjekti politik i cili ka fituar zgjedhjet, për të krijuar hapësirën e nevojshme kohore për subjektin politik që të arrijë të krijojë shumicën parlamentare përmes arritjes së marrëveshjeve me subjektet tjera politike. Një konstatim i tillë vërtetohet edhe nga vetë praktika e Gjykatës Kushtetuese, ku në rastin *KO 29/11*, paragrafi 71, specifikohet se "*nëse qëllimi i hartuesve të Kushtetutës do të kishte qenë që të paraqisnin një procedurë alternative për zgjedhje, vetëm me një kandidat të nominuar, Kushtetuta, shprehimisht do e kishte parashikuar një procedurë të tillë.*" Edhe në rastin konkret, mungesa e një norme të tillë dëshmon se nëse ligjvënësit do të donin të caktonin afat, do ta bënin këtë shprehimisht siç kanë bërë në shumë raste të tjera në dispozita kushtetuese.
27. Gjykata Kushtetuese, përmes rasteve të trajtuara paraprakisht, ka krijuar hapësirën e nevojshme për subjektet politike që vetvetiu të rregullojnë ndërveprimin politik, pa ju caktuar afat për një gjë të tillë. Kjo dëshmohet përmes paragrafit 127 të rastit *KO119/14*, ku Gjykata kishte konstatuar se "*është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese në lidhje me Rregulloren relevante të Kuvendit dhe të bëjnë Kuvendin funksional*". Pra, edhe pse parashtruesit e kërkesës në rastin në fjalë argumentonin se partia e parë për muaj të tërë nuk dërgonte emër për Kryetar Kuvendi (duke mbajtur institucionet e pakonstituara), dhe se nuk do të duhej të pritej pafundësisht por ti jepej e drejta të tjerëve për propozime, gjykata vendosi që vetëm partia e parë mund të propozojë atë emër. Kësisoj, Gjykata nuk caktoi afate, por e la një gjë të tillë tek jeta politike, pra që deputetët ta

gjejnë një mënyrë për t'u krijuar shumica e nevojshme. Gjykata asnjëherë nuk u caktoi deputetëve afat për 'ta gjetur këtë mënyrë'.

B. PRESIDENTI KA VETË-CAKTUAR KOMPETENCA PËR INTERPRETIM PËRFUNDIMTAR TË KUSHTETUTËS

28. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është mjaft e qartë dhe koncize edhe në kuptim të definimit të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese. Një kompetencë e tillë i është dhënë ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese, e cila sipas definicionit kushtetues është "*[...] organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*"
29. Neni 112 i Kushtetutës së vendit, që paraqet edhe definimin kushtetues të Gjykatës Kushtetuese, qartësohet edhe më tej në Komentarin e Kushtetutës. Koncepti që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar i interpretimit të kushtetutës është i lidhur me pozitën hierarkike institucionale që kësaj gjykate i jep ky paragraf. Në këtë kuptim, ky paragraf e vendos Gjykatën Kushtetuese në pikën më të lartë të hierarkisë institucionale sa i përket funksionit të interpretimit të kushtetutës. Kjo, në kuptimin institucional ka katër domethënie:
- a) *Që asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t'i marrë apo të ushtrojë në emër të Gjykatës Kushtetuese funksionin e interpretimit përfundimtar kushtetues;*
 - b) *Që, edhe nëse cilido institucion tjetër shtetëror ka bërë interpretimin apo është referuar tek kushtetuta për të ushtruar një kompetencë të tij/saj, kjo mund të konsiderohet përfundimisht e përcaktuar vetëm nëse kalon përmes filtrit të vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese;*
 - c) *Asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të shfrytëzojë prerogativat e tij/saj faktike për të vendosur nënkuptime të domethënies së kushtetutës, dhe se prerogativat e tilla mund të konsiderohen kushtetuese vetëm nëse kalojnë përmes vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, dhe*
 - d) *Asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t'i ikë detyrimit (bishtnoj) që të ndjek interpretimin e kushtetutës sipas Gjykatës Kushtetuese, meqë kjo e fundit sipas këtij paragrafi është autoriteti i fundit institucional për interpretimin e saj.*
30. Kjo dispozitë kristalizon çështjen e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke e veshur vetëm Gjykatën Kushtetuese me të drejtën e interpretimit të

Kushtetutës. Po ashtu, duke e vendosur Gjykatën në hierarkinë më të lartë juridike për interpretim të Kushtetutës, vendimeve të Gjykatës i është dhënë epërsi e plotë juridike krahasuar me vendimet e cilitdo institucion tjetër në Republikën e Kosovës.

31. Sa i përket çështjes konkrete, gjegjësisht rolit aktiv të Presidentit në rastet kur Kushtetuta qëndron e heshtur, sikurse në rastin e formimit të Qeverisë, respektivisht të konstatimit të situatave juridike pa shprehje formale të vullnetit të partisë politike të cilës i është njohur kjo e drejtë dhe detyrim me Kushtetutë, diçka e tillë nuk parashihet në asnjë formë në asnjë prej neneve por as në kuadër të frymës kushtetuese.
32. Me qëllim të garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve, Presidentit i është njohur me Kushtetutë e drejta e ngritjes së çështjeve në Gjykatën Kushtetuese. Pra, bazuar në këtë linjë të argumentimit, më e shumta që Presidenti i vendit mund të bëjë nëse ai konstaton se është duke u cenuar funksionimi kushtetues i institucioneve, apo nëse ekzistojnë paqartësi procedurale sipas nenit 95 të Kushtetutës, është që në cilësinë e palës së autorizuar, të ngritë çështjen përkatëse për interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Historia politike e Republikës së Kosovës tanimë ka edhe një precedent të tillë, në vitin 2014. Atëbotë, Presidentja e vendit, znj. Atifete Jahjaga, përkundër pritjes disa-mujore para nominimit të kandidatit nga subjekti fitues i zgjedhjeve si mandatar për Kryeministër, për të garantuar siguri juridike për veprimet e ndërmarra, kishte parashtruar pyetje në Gjykatën Kushtetuese për të sqaruar situatën e krijuar. Gjykata Kushtetuese shpalli të pranueshme kërkesën dhe ofroi verdiktin e saj, në rastin *KO103/14*.
33. Përmes kësaj formë të plotësisht të Kushtetutës më anë të dekretit, Presidenti i ka pamundësuar Gjykatës Kushtetuese edhe një kompetencë tjetër: atë të ushtrimit të juridiksionit të saj në vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve, siç parashihet në nenin 113(9) të kushtetutës. Dekreti është amendament që ka caktuar afat kohor duke zvogëluar një të drejtë të caktuar të një subjekti. Pra, kjo nënkupton që individëve të caktuar u është pamundësuar e drejta për tu zgjedhur, si rezultat i caktimit të një periudhe kohore jo-kushtetuese. Kësajsoj, dekreti në fjalë bie ndesh edhe më Nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] paragrafin 1 dhe 2. Sipas Kushtetutës, një e drejtë e tillë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor, dhe jo me dekret të Presidentit si në këtë rast. Për më tepër, paragrafi

3 i nenit 45 sqaron se “*institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike*”. Këtu, në kuadër të institucioneve shtetërore hyn edhe Presidenti, i cili duhet të mbështes mundësinë për pjesëmarrje dhe jo të kufizojë në aspektin kohor mundësinë e tillë të garantuar me Kushtetutë me anë të Dekretit.

34. Është pikërisht Gjykata Kushtetuese e cila në aktgjykimin KO 29/12 dhe KO48/12, kishte analizuar amendamentin kushtetues të nenit 45.1 i cili propozonte tekstin si në vijim (çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor ose me dispozitat e kësaj Kushtetute."
35. Amendamenti propozonte që të shtohet pjesa “ose me dispozitë të kësaj kushtetute”. Gjykata Kushtetuese duke analizuar amendamentin e propozuar sqaronte si në vijim: “Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 45.1. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 45.1 nuk pakëson ndonjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”. Ky interpretim i gjykatës në rastin KO29/12 dhe KO 48/12 është edhe një argument shtesë apo një sinjal që përcaktimi i afateve të tilla në kushtetutë, çfarë ka tentuar të bëjë Presidenti më anë të dekretit, mund të bëhet vetëm më dispozita kushtetuese. Në këtë pikë, dëshiroj të sqaroj se qëllimi nuk është paragjykimi mbi interpretimin që mund të bëjë gjykata ndaj një amendamenti kushtetutës që përcakton afate kohore, por të sqaroj se praktika e Gjykatës Kushtetuese njeh standardin e kufizimit të kësaj të drejte vetëm me dispozitë kushtetuese dhe assesi me ndonjë akt tjetër, siç është tani rasti me dekretin e Presidentit.
36. Prandaj, mundësimi i interpretimit të njëanshëm të Kushtetutës apo frymës së saj nga ana e Presidentit, në mungesë të normës kushtetuese rreth afatit, do të cenonte rëndë parimin e ndarjes së pushteteve, si dhe do të rrezikonte funksionimin kushtetues dhe demokratik të institucioneve tjera, posaçërisht meqenëse një gjë e tillë do t’ia pamundësonte Gjykatën në ushtrimin e detyrave të saja, të parapara në mënyrë eksplicite me Kushtetutë.

37. Për më shumë, tejkalimi i rolit dhe funksionit interpretues të Gjykatës në çështjet kushtetuese, nga cilido institucion tjetër, do të mund të sillte rrënimin e rendit juridik dhe interpretim të njëanshëm të Kushtetutës nga secili institucion, duke krijuar kështu një situatë juridiko-anarkike.
38. Shfrytëzoi këtë rast që kësaj Gjykate të nderuar t'ia tërheqë vëmendjen edhe tek pasojat e Dekretit të Presidentit Nr. 24/2020, të cilat u parandaluan në momentin e fundit nga kjo Gjykatë e nderuar përmes miratimit të masës së përkohshme. Cenimi serioz i Kushtetutës përmes këtij Dekreti nga ana e Presidentit solli vendin në një krizë shumë të rrezikshme jo vetëm politike, por edhe shëndetësore, të cilat i kam sqaruar *ad nauseam* në komentet e datës 2 maj 2020 që kam dërguar përkitazi me masën e përkohshme dhe që për hir të efikasitetit nuk i ripërsëris këtu. Mirëpo, në vlerësimin e seriozitetit të cenimit të Kushtetutës nga ana e Presidentit, me respekt kërkoj nga kjo Gjykatë e nderuar që të ketë parasysh edhe këtë kontekst tejet të rrezikshëm të rrethanave në të cilat Presidenti bëri shkeljet në fjalë.
39. Statusi i Presidentit të vendit, sipas Kushtetutës, është i njohur si "përfaqësues i unitetit të popullit të Republikës së Kosovës". Ky status i Presidentit qartësohet edhe më tej me Komentarin e Kushtetutës, në relacion me nenin 83, ku ndër të tjera shpjegohet se "*në kryerjen e detyrës së tij/saj si kreu i shtetit, Presidenti i Republikës, sipas nenit 83, duhet të veprojë në linjë me të mirën publike të tërë shtetit dhe jashtë çdo linje të ngushtë partiake apo personale. Funksioni i kreut të shtetit, prandaj, është funksion që kërkon integritet neutral dhe përmbajtje meritore, meqë materializimi i vendimeve në kuadër të këtij funksioni duhet të përfaqësoj të mirën publike/shtetërore para interesave elektorale/partiake*". Madje, Gjykata Kushtetuese ka rikonfirmuar pozitën e kreut të shtetit karshi interesit publik, edhe në paragrafin 63 të Aktgjykimit të rastit KO103/14, ku kishte konstatuar se "[...]Gjykata konsideron se është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që "përfaqëson unitetin e popullit" dhe jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t'i përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës ka të drejtë të sigurohet për paanshmerinë, për integritetin dhe për pavarësinë e Presidentit të tyre".
40. Për të përkrahur një linjë të njëjtë të argumentimit, Gjykata mund t'i referohet edhe opinionit të Komisionit të Venecias CDL-AD(2019)019-e, që trajtonte kompetencat e Presidentit të Shqipërisë për të caktuar datën e zgjedhjeve. Përmes opinionit, Komisioni i Venecias në pikat 40 dhe 41 të opinionit

konstatohej se "ndonëse Presidenti konsiderohet si kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit, këto kualifikime nuk do të thotë që autoriteti i Presidentit është mbi politikën. Ato do të thonë se Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partizane, me qëllim që të sigurojë, mes të tjerash, një konkurrencë të ndershme midis partive dhe funksionimin e rregullt të formës së qeverisë dhe veprimtarive tjera të shtetit." Kjo linjë e interpretimit është e njëjtë me dispozitat kushtetuese në Republikën e Kosovës, meqë roli i Presidentit edhe në Kosovë është i tillë ku kërkohet përfaqësimi i unitetit të popullit dhe neutraliteti i plotë politik, duke mbrojtur kështu, siç sugjeron edhe vetë Komisioni I Venecias, funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes. Forma e qeverisjes, nuk mund të mbrohet duke shkelur parimin më fundamental të saj, atë të ndarjes së pushteteve.

41. Duke pasur parasysh tërë atë që u tha më sipër, kërkoj me respekt nga kjo Gjykatë e nderuar që të shpallë një Aktgjykim, përmes të cilit konstaton se Dekreti i Presidentit Nr. 24/2020 është në kundërshtim me Kushtetutën sepse nëpërmjet këtij Dekreti, Presidenti i vendit ka tejkaluar kompetencat e veta duke ndërhyrë në kompetencat e institucioneve të tjera dhe rrjedhimisht duke rënë në kundërshtim me parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.

Me respekt,

Vjosa OSMANI-SADRIU

Kryetare e Kuvendit të Kosovës